

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"Çupi", BX NËL 37 kapitulli IV LIGJI MBI SHOQËRITË  
KOMERCIALE

Në Tiranë më datë \_\_\_\_\_ 1994

Unë i quajtarë Demir Çupi i biri i Zyberit, i datëlindjes 196 :  
lindur dhe banues në Burrel :

Në mbështetje të ligjeve nr 75 datë 10.08.1991 "Për sanksionimin  
dhe mbrojtjen e pronave private të pavarura dhe të privatizimit" nr 7638  
datë 19.11.1992 " Për shoqëritë tregtare" si dhe të ligjit nr 7696 datë 7  
7.4.1993 "Për shërbimin e Rojeve civile"

V E N D O S A

Të themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "Çupi" (SHPK).  
Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie është aktiviteti i survejimit,  
ruajtjes, mbrojtjes së të mirave të tundshme dhe të patundshme, të  
pasurisë apo në përdorim të personave të tretë, qofshin këto publike  
apo private, si dhe mbrojtja personale e personave fizikë pa kushtëzime  
qyteti apo kombësie.

Survejimi, mbrojtja apo ruajtja do të ushtrohet mbi personat  
apo të mirat qofshin këto në një vend apo në lëvizje.

Aktiviteti do të ushtrohet duke përdorur persona fikse (ose të  
ndryshueshëm që vlejnë si mjet transporti) dhe mbrojtje të autorizuar  
nga autoritetet kompetente, me aparate elektronike, radio të lëvizshme  
ose të palëvizshme.

Shoqëria mund të verë në dukje qfardo lloj aksioni lidhur me  
shtimin e qëllimit shoqëror që do të mund të hapë dhe të krijojë filialet  
e seli sekondare në Shqipëri dhe jashtë.

Mund të ushtrojë aktivitet informimi, hetimi dhe kërkimi për  
llogari të ndërmarrjeve publike dhe private.

Dë të mund të shesë e të blejë të mira të tundshme e të pa-  
tundshme në base të statutit në bashkëlidhje.

Selia e shoqërisë private "Çupi" SHPK, do të jetë në Burrel  
Lagjia "Drita".

Shënia mund të hape nëndegë të saj jo vetëm në rrethin e Matit por në të gjitha qytetet e Shqipërisë, konform ligjit.  
Shoqëria do të fillojë të ushtrojë veprimtarinë e saj pas miratimit nga shteti pasi të paiset me autorizim nga organet përkatëse.

Kapitali i saj fillestar do të jetë 100.000 lekë (njëqind mijë).  
Ortak dhe administrator i vetëm i shoqërisë do të jetë Demir Çupi.  
Veprimtarinë e saj do ta zhvillojë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe statutin e hartuar për këtë qëllim.

THEMBLUESI I SHOQËRISË "ÇUPI"

/ DEMIR ÇUPI /

## S T A T U T I

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "ÇUPI" (SHPK)

#### F O R M I M I

##### Neni 1

Formohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) "ÇUPI" Ortaku i vetëm i saj Demir Çupi i biri i Zyberit, datëlindja 196 , lindur dhe banues në Burrel

#### VENDQËNDRIMI I SHOQËRISË

##### Neni 2

Vend qëndrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Çupi" është në qytetin e Burrelit me adresën lagjia "Drita ap\_\_\_\_\_".

Shoqëria mund të hapë edhe vendqëndrime të tjera operative filiale, përfaqësi e agjensi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë sajme miratimin e organeve kompetente dhe sipas legjislacionit të vendit ku do të hapen.

#### KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

##### NENI 3

Kohëzgjatja e shoqërisë (SHPK) Çupi është mbi 10 vjet dhe mund të shpërbëhet në çdo kohë.

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së SH.P.K "Çupi" dotë jetë:

Aktiviteti i survejimit, ruajtjes, mbrojtjes së të mirave të natyrore dhe të patundshme, të objekteve të ndryshme publike apo private mbrojtja e personave fizike pa kushtëzime qyteti apo kombësie, kryerja e shërbimit të rojeve civile në objekte të ndryshme si minierë etj, mbrojtja e pasurisë qofte edhe në përdorim të personave të tretë etj si dhe prodhimi dhe tregtimi i materialeve të ndërtimit apo i mallrave të ndryshme ushqimore apo industrialeme shumicë dhe pakicë, import eksport, transportim vlerash monetare brënda dhe jashtë vendit.

##### NENI 5

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Çupi" mund të ndryshojë emërinë vendqëndrimin, dhe objektin e veprimtarisë së saj, sipas vendimit që do të marrë asambleja e Ortakëve.

 KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6

Kapitali i SHPK "Çupi" është 100000 (njëqindmijë) lekë. të vena kryesisht nga ortaku i vetëm Demir Çupi.

Neni 7

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet e paksohet në bazë të vendimeve të marra ose që do të marrë Asambleja e Ortakut të vetëm.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 8

Shoqëria me ortakun e vetëm Demir Çupi, qeveris veprimtarinë e saj ekonomike, duke u mbështetur në të drejtën e saj në pronën private dhe mjetet e investuara në shoqëri.

Neni 9

Shoqëria krijohet dhe fiton zotësinë e e saj për të vepruar nga dita e regjistrimit të saj në regjistrin e gjykatës së rrethit Tiranë, si person juridik. Ajo deklarohej e krijuar në zbatim të ëlotë të nermave që përmban ky statutsi dhe legjislacioni shqiptar në fuqi. Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj ekonomik me regjistrimin e saj në Organin përkatës. Të drejtën e përdorimit të vulës e kanë ortakët e saj dhe personat e autorizuar prej tyre.

Neni 10

Shoqëria vepron me të drejtën e pronës private dhe merr përsipër vetë të drejtat dhe detyrimet. Ajo përgjigjet vetë për detyrimet e saja kontraktore dhe jashtëkontraktore brënda kapitalit të saj. Ortaku imbart rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë në nivelin e shumës së mjeteve të investuara në kapitalin e shoqërisë.

Neni 11



Ortaku në bazë të vendimeve që merr asambleja, emëron administrator dhe punëson punëtorë në aktivitete të ndryshme sipas nevojave që ka.

Neni 12

Ortaku i shoqërisë dhe administratorët e emëruar prej tij janë të veshur me të gjithë fuqitë për drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm pa asnjë përjashtim ose kufizim. Ata kanë mundësi të kryesjnë të gjitha aktivitetet që konsiderohen të nevojshme për arritjen e qëllimeve të shoqërisë.

Ai ka mundësi dhe të drejtën të blerjes e të këmbimit të pasurive të veprimeve që lidhen me shoqëri të tjera. Ajo kryen çdo lloj veprimi pranë gjithë zyrave shtetërore dhe private që kanë të bëjnë me garancitë dhe veprimet ipotekore. Në të tilla raste administratori i emëruar ose i "autorizuar nga ortaku i vetëm i shoqërisë jep llogari para tij.

MARDHËNIET E PUNËS

Neni 13

Mardhënit e punës rregullohen sipas kontratës së punës. Mosmarrveshjet e punonjësve zgjidhen nga gjykata e rrethit. Kur pala ankuese është person i huaj, mosmarrveshjet zgjidhen nga organet kompetente që përcaktohen në kontratën e punës.

Neni 14

Ortaku i vetëm i shoqërisë përcakton administratorë e punonjës të tjerë, të cilëve ju cakton rrogat dhe detyrat. Shoqëria respekton rregullat e punësimit dhe të sigurimeve shoqërore, kurse të punësuarit janë të detyruar të punojnë dhe të zbatojnë këto Statut. Administratori nuk mund të marrë cilësitë e ortakut të shoqërisë dhe as ushtrojë aktivitete kontraktore çdo lloji për llogari të tij dhe të tretëve, për çdo shkelje në këtë drejtim ai përgjigjet për dëmet e shkakësuara.

Neni 15

Të gjithë të përfunduarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë siç janë: Shkresat, materialet dhe aktet që me ligj e me dispozita të veçanta janë shpallur sekret pune që u jepen organeve kompetente të mitatuara dhe të nënshkruara nga ortaku i vetëm i shoqërisë.

PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË

Neni 16

Përfaqësimi i SHPK "Çupi" i përket ortakut të saj të vetëm Demir Çupi si dhe administratorëve të emëruar apo të autorizuar prej tij. Ata kanë të drejtë të përfaqësojnë shoqërinë në organet gjyqsore e në gjykatë të caktojnë apo heqin avokatin në gjykimet etj.

Administratori i shoqërisë është ortaku i vetëm Demir Çupi.

BILANCI DHE TË ARDHURAT

Neni 17

Veprimet ekonomike dhe financiare të shoqërisë mbylLEN me dt 31 dhjetor të çdo viti, përveç urdhërave të veçantë që do të japë ortaku i vetëm i shoqërisë.

Në fund të çdo periudhe administratori nxjerr bilancin kontabël dhe kryen veprimet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Bilanci kontabël miratohet nga ortaku i vetëm i shoqërisë brënda 6 muajve nga mbyllja e vitit. Ortaku i vetëm i shoqërisë vendos për krijimin e përdoreshmërisë së fondeve disponibël. Të ardhurat neto pas veçimit të fondeve të mësipërme i mbeten ortakut të vetëm të shoqërisë.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përsa nuk është shprehur plotësisht në këtë statut, i referohet plotësisht që do të bëjë ortaku i vetëm i shoqërisë si dhe në ligje të veçanta të shoqërisë. Ky statut hyn në fuqi me regjistrimin në gjykatë. Statuti nënshkruhet rregullisht nga ortaku i vetëm i saj.

ORTAKU I VETËM I SHPK "ÇUPI"

DEMIR ÇUPI